



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë më 07.11.2018

R A P O R T **PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2019”** *(shqyrtimi në parim)*

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 7.11.2018 bëri prezantimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”, të paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

Në mbledhjen e komisionit morën pjesë ministri i Financave dhe Ekonomisë, z.Arben Ahmetaj dhe përfaqësues të kësaj ministrie, të cilët bënë paraqitjen e projektbuxhetit për vitin 2019 dhe iu përgjigjën pyetjeve në parim të anëtarëve të Komisionit për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

I. Baza kushtetuese e projektligjit, vlerësimi kushtetues dhe procedural

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2019” është propozuar nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në:

- nenet 78, 83, pika 1, 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Nenin 30 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

II. Objektivat e Buxhetit 2019

- a. Projektbuxheti 2019 mbështet konsolidimin e mëtejshëm të reformave të ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritimit në Bashkimin Europian.
- b. Politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal për të vijuar trajektoren rënëse të raportit të borxhit publik ndaj PBB.

- c. Rritja ekonomike dhe punësimi, do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të investimeve publike prej 5% e PBB. Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të forcohet dhe të arrijë nivelin 4.3% në vitin 2019.
- d. Defiçiti buxhetor për vitin 2019 planifikohet në nivelin 1.9% të PBB, që është niveli më i ulët i targetuar në ligjin vjetor të buxhetit në dy dekadat e fundit.
- e. Më shumë burime si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Rritja e të ardhurave është synuar kryesisht nga zgjerimi i bazës së tatueshme, lufta ndaj informalitetit dhe përmirësimi i administrimit tatimor.
- f. Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2019-2021 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike duke u përqendruar në financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe veçanërisht mbështetjen e sektorit të bujqësisë.
- g. Rijetëzimi rural do të jetë fokusi kryesor i mbështetjes së qeverisë për zhvillimin rajonal. Programi konsiston në konsolidimin e investimeve publike, atyre të donatorëve dhe i investimeve private, në hapësirën e 100 fshatrave, me potenciale të larta zhvillimi ekonomiko-sociale, të agroturizmit e turizmit rural, natyrës dhe mjedisit, si dhe të trashëgimisë kulturore.

II.1 Realizimi i reformave

➤ *Reforma e Drejtësisë*

Sipas relacionit shoqërues, një nga objektivat kryesore të këtij projektbuxheti është mbështetja e zbatimit të Reformës në Drejtësi, e cila prek drejtpërdrejt sistemin gjyqësor dhe kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë në funksionimin dhe organizimin e këtij sistemi.

Reforma në Drejtësi ka synim të përgjithshëm krijimin e një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili të gëzojë besimin e publikut, të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit dhe të mundësojë integrimin e tij në familjen evropiane. Reforma në drejtësi është një ndër prioritetet kyçe të Qeverisë Shqiptare dhe një ndër çështjet më të përshtatshme që duhen trajtuar në kudër të pesë përparësive kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit me BE-në.

Objektivat e Reformës në Drejtësi ne periudhën afatgjatë janë:

- Forcimi i statusit të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjitha niveleve, përfshirë ndihmës-magjistratët /këshilltarët ligjorë në përputhje me standardet evropiane që sigurojnë emërim dhe zhvillim të karrierës që janë të bazuara në meritë;
- Krijimi i një inspektorati të vetëm të pavarur përgjegjës për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për të zhvilluar shërbime të tjera inspektimi në gjykata dhe prokurori në përputhje me standardet evropiane;
- Rritja e funksionimit të KLGJ dhe zgjerimi i objektit të kompetencave të tij, duke i bërë gjykatat më të larta pjesë të objektit të saj dhe duke zgjeruar funksionet, p.sh. në lidhje me IT, buxhetin gjyqësor, administrimin e gjykatave, raportimin dhe marrëdhëniet me publikun në bazë të standardeve Evropiane dhe ndërkombëtare.

- Krijimi i KLP dhe ngritja e kapaciteteve në bazë të standardeve moderne evropiane dhe zbatimi i ndryshimeve të fundit ligjore
- Krijimi i një strukture të specializuar anti-korrupsion në nivel kombëtar, të përbërë nga policia, prokuroria dhe gjykata.

Për të garantuar suksesin e reformës në drejtësi, në projekt-buxhetin e vitit 2019, është programuar një fond rezervë i sistemit të drejtësisë **prej 1,5 miliard lekë**. Fondi rezervë i sistemit të drejtësisë do të përdoret deri në 1 miliard për financimin e pagave të reja të magjistratëve dhe deri në 500 milion lekë për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë.

Projektligji për buxhetin e vitit 2019 reflektohen parashikimet e bëra nga ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në lidhje me sistemin e pagave të magjistratëve.

Projekt-buxheti 2019 siguron gjithashtu vijimin e mbështetjes për tre organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke garantuar burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për të përmbushur qëllimet të ushtrimit të funksioneve në mënyrë të plotë e të pavarur, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

➤ **Reforma e administratës Publike**

Reforma në administratën publike në Shqipëri vijon të jetë një proces i rëndësishëm dhe kyç, i lidhur ngushtë me procesin e integritetit në Bashkimin Evropian (BE) si dhe një nga parakushtet kryesore për një qeverisje transparente dhe efektive.

Prioritetet për vitin 2019:

- *Zbatimi i Planit të Ri të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike* dhe aktiviteteve për periudhën 2018-2020 synon fuqizimin e strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimit ndaj publikut.
- Zbatimi i projektit IPA 2014 “*Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike*”, i cili ka nisur më datë 9 tetor 2018 dhe do të ketë një kohëzgjatje prej 30 muajsh.
- *Vijimin e zbatimit të Programit për Administratën që Duam*, një program i qeverisë shqiptare për energjizimin e administratës publike nëpërmjet orientimit të përpjekjeve të administratës drejt prioriteteve dhe vizionit qeverisës, rritjes së aftësive dhe kapaciteteve profesionale të nëpunësve publikë, motivimit dhe angazhimit të tyre si dhe rritjes së ndërveprimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional.
- *Zhvillimi i Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SMIBNJ/HRMIS)* dhe finalizimi i bashkërendimit midis HRMIS dhe sistemit të thesarit.
- *Projekti nën IPA 2015 “Profesionistë të rinj për Shqipërinë”* do të jetë në formën e një granti, ku objektivi kryesor i zbatimit të këtij projekti do të jetë rritja e kapacitetit dhe ekspertizës së nëpunësve civilë në sektorët kryesorë në përputhje me prioritetet e Qeverisë dhe me kërkesat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Nëpërmjet këtij projekti është parashikuar realizimi i dy objektivave/rezultateve specifike:
 - Përmirësimi i kapacitetit profesional dhe ekspertizës së nëpunësve civilë në sektorët kyç të administratës publike shqiptare.
 - Zhvillimi i mekanizmave të qëndrueshëm, që synojnë mbështetjen e zhvillimit të

karrierës së nëpunësve të rinj civilë të aftë, duke u mundësuar atyre që të kontribuojnë dukshëm në efikasitetin dhe prurjen e risive në administratën publike shqiptare dhe në reformat kryesore.

II.2 Buxheti Vendor

Thellimi i decentralizmit fiskal, rritja e autonomisë financiare dhe konsolidimi i financave vendore janë ndër objektivat kryesore të qeverisë në drejtim të përdorimit me efektivitet të fondeve publike në nivel vendor dhe përmirësimit të shërbimeve. Viti 2019, parashikohet të jetë viti i implementimit të plotë të të gjithë instrumentave të reja të parashikuara në ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore duke konsoliduar burimet e financimit dhe sigurojnë një menaxhim më cilësor të shpenzimeve vendore.

Buxheti i pushtetit vendor për vitin 2019, do të jetë rreth **11 përqind** më i lartë se ai i 2018-ës ose **5 miliardë lekë** më shumë fonde për shërbime dhe investime publike. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme e buxhetit të shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore do të jetë 1 përqind e PBB-së ose **1 miliard lekë** më e madhe se sa ajo e vitit 2018

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat në vitin 2019 do të jenë **22.6 miliardë lekë** ose **21 përqind** më të larta se në vitin 2018. Të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2019, krahasuar me vitin 2015, si viti para zbatimit të reformës administrativo-territoriale, janë dy herë më të larta, **10 miliardë lekë** më shumë. Buxheti për vitin 2019 do të jetë 2.92 përqind e PBB-së, dhe krahasuar me vitin 2015 rezulton me një rritje të ndjeshme me rreth 50 përqind.

- **Objektivat kryesore për buxhetin vendor të vitit 2019**, do të jenë në drejtim të:
 - a. Rritjes së burimeve të financimit të qeverisjes vendore me rreth 5 miliardë lekë ose 11% më shumë se në vitin 2018 që sigurohet nga transferata e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat e tarifat vendore. Kjo rritje krijon hëpësirat e nevojshme për përmirësimin e shërbimeve publike dhe fokusim më të madh në investime kapitale;
 - b. Ngritjes së kadastrës fiskale dhe implementimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore me qëllim taksimin sa më të drejtë, me objektiv rritjen e të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
 - c. Rritjes së fondeve për pagat e edukatoreve të arsimit parashkollor krahasuar me vitin 2018;
 - d. Harmonizimit dhe unifikimit të procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, konform standarteve ndërkombëtare;
 - e. Rritjes së investimeve vendore me rreth 60% krahasuar me vitin 2014, në funksion të zhvillimit ekonomik vendor;
 - f. Menaxhimit më të mirë të shpenzimeve administrative me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve publike cilësore me një kosto sa më të ulët.
 - g. Rritjes së eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike në nivel vendor, duke identifikuar tregues të performancës së shërbimit të ofruar;
 - h. Rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin, në drejtim të monitorimit të publikimit të dokumentave buxhetorë dhe zhvillimin të seancave të vazhdueshme të konsultimit me qytetarët.

Fokusi kryesor në buxhetin vendor të vitit 2019, do të jetë në funksion të vazhdimin të zbatimit të reformës administrative territoriale dhe decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet:

- Rritjes së nivelit, stabilitetit dhe parashikueshmërisë së transfertave ndërqeveritare.
- Konsolidimit të procedurave dhe sistemit të menaxhimit të financave vendore në të gjitha hapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij.
- Sigurimit të menaxhimit financiar transparent dhe efektiv për të gjitha njësitet e vetëqeverisjes vendore;
- Planifikimit dhe buxhetimit eficient dhe të mirë-integruar i shpenzimeve publike në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe përdorimit me ekonomi të fondeve vendore;
- Unifikimit të standardeve të procesit të hartimit të programit buxhetor afatmesëm dhe programimi mbi bazën e një sistemi të unifikuar programesh;
- Përmirësimit të cilësisë së raporteve të monitorimit të buxhetit vendor dhe krijimi i një sistemi të monitorimit mbi bazën e treguesve të performancës.
- Garantimit të një sistemi të financave publike vendore që nxit transparencën, përgjegjshmërinë dhe eficiencën në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike.
- Implementimit të një metodologjie të mirëstrukturuar në lidhje me evidentimin e rasteve të vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA LIDHUR ME PROJEKTBUXHETIN NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE

Gjatë prezantimit të projektbuxhetit në Komision, Ministri i Financave. z.Arben Ahmetaj prezantoi përpara deputetëve objektivat e projekt-buxhetit të vitit 2019, në themel të të cilit është konsolidimi i mëtejshëm fiskal, rritja ekonomike, por edhe vazhdimësia e reformave kryesore, një prej të cilave është edhe reforma në drejtësi.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë parashitroi përpara anëtarëve të Komisionit se Reforma në drejtësi, do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore, së bashku me reformën në administratën publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre.

Sipas prezantimit të bërë, projektligji për buxhetin e vitit 2019, akomodon sistemin e ri të pagave të magjistratëve i cili parashikohet të hyjë në fuqi në 1 Janar 2019 si dhe parashikon një fond të posaçëm për ngritjen e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë të krijuara për mbështetjen e kësaj reforme.

Relatori në fjalën e tij e vuri theksin tek rëndësia e projekt-buxhetit 2019 i cili mbështet reformat kryesore si reforma në drejtësi dhe reforma administrative-territoriale, si dhe konsolidimin e mëtejshëm të financave të njësive të qeverisjes vendore. Relatori solli në vëmendjen e përfaqësuesve të ministrisë së financave dhe ekonomisë nevojën për kryerjen e një analize të hollësishme me qëllim reformimin e sistemit të pagave në vendin tonë.

Në vazhdim të diskutimit në Komision, ministri Ahmetaj iu përgjigj pyetjeve të deputetëve lidhur me parashikimet e buxhetit për disa fusha, si në investimet publike në rrugë, turizëm, bujqësi, si dhe për administrimin e taksës vendore nga pushteti vendor.

Pas përfundimit të pyetjeve dhe diskutimeve të zhvilluara nga anëtarët e Komisionit, si dhe përgjigjeve të dhëna, **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me shumicën e votave të anëtarëve, miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”, duke konstatuar se:**

- Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën, nenet 78, 83, pika 1 dhe 158 të saj;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur dhe po shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Komisioni i Ligjeve, në përputhje me afatet e përcaktuara Kalendarin e Kuvendit sipas nenit 79 të Rregullores për shqyrtimin e projektligjit të Buxhetit të vitit 2019, dhe bazuar në nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, e paraqet këtë raport në Komisionin përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

RELATORI

KRYETARI

Bashkim FINO

Ulsi MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë më 23.11.2018

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2019”

(shqyrtimi nen për nen)

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjet e datave 7 dhe 8 nëntor 2018, bëri prezantimin nen për nen të projektligjit “Për Buxhetin e Shtetit të Vitit 2019” si dhe zhvilloi seanca dëgjimore me institucionet shtetërore, kushtetuese dhe të pavarura, sipas fushës së veprimtarisë së tij, konkretisht me:

1. *Ministrinë e Drejtësisë;*
2. *Ministrinë e Brendshme (Gjendja Civile, Çështjet Vendore dhe Prefekturat);*
3. *Presidencën;*
4. *Prokurorinë e Përgjithshme;*
5. *Zyrën e Administrimit të Buxhetit të Pushtetit Gjyqësor;*
6. *Këshillin e Lartë të Drejtësisë;*
7. *Gjykatën Kushtetuese;*
8. *Avokatin e Popullit;*
9. *Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;*
10. *Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;*
11. *Shkollën e Magjistraturës;*
12. *Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;*
13. *Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;*
14. *Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi;*
15. *Autoritetin Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit;*
16. *Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit;*
17. *Komisionin e Pavarur të Kualifikimit;*
18. *Kolegjin e Posaçëm të Apelit;*
19. *Komisionerët Publikë.*

Pas prezantimeve që bënë titullarët dhe përfaqësuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve shtetërore, Komisioni konstatoi se:

▪ **Për projektbuxhetin e Ministrisë së Drejtësisë**

Prezantimi i projektbuxhetit për ministrinë Drejtësisë u bë nga zëvendësministri i Drejtësisë z. Toni Gogu.

Lidhur me prioritetet e projekt-buxhetit 2019, Ministria e Drejtësisë, midis të tjerave, do të jetë e fokusuar në:

- Jetësimin e Reformës në Drejtësi;
- Forcimin e luftës kundër Korrupsionit në Administratë;
- Legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve dhe zonave informale.
- Rregullimin e çështjes së pronave në zbatim të ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe akteve nënligjore;
- Garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve dhe sigurimin e ri-integrimit të tyre në shoqëri;
- Rritjen e performancës së Shërbimit të Provës në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve më të larta në fushën e masave alternative për realizimin e programeve sa më efikase në realizimin e rehabilitimit të të dënuarve me masa alternative.

Në projektligjin e buxhetit të vitit 2019 Ministria e Drejtësisë ka në përbërje të saj shtatë programe buxhetore, të cilat janë ndarë në: planifikim– menaxhim – administrim; Publikimet Zyrtare, Mjekësia Ligjore, Sistemi i Burgjeve, Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor, Shërbimi për Çështjet e Birësimeve, Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Shërbimi i Provës. Buxheti total i planifikuar për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2019 është 12 miliard lekë.

Gjatë diskutimit në Komision Ministria e Drejtësisë, kërkoi:

- shtesë në zërin shpenzime operative në masën 643 milion lekë për policinë e burgjeve, për unifikimin e gradave;
- shtesë në zërin shpenzime kapitale 100 milion lekë për institutin e të miturve;

Në përfundim, Komisioni, pas rakordimit dhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, vlerësoi se kërkesa për shtesë fondi për unifikimin e gradave në Policinë e Burgjeve është akomoduar në projekt-buxhetin e vitit 2019, në të cilin është parashikuar rritje të pagave për Policinë e Burgjeve duke filluar nga data 1 Prill 2019.

Gjithashtu, Komisioni për Çështjet Ligjore, gjatë diskutimit të projektbuxhetit nën për nen, rekomandoi që në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë të parashikohet si zë i vecantë buxheti për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Kjo në funksion të respektimit të detyrimit ligjor të parashikuar nga ligji 111/2017 sipas të cilës fondet për ndihmën juridike të garantuar nga shteti përbëjnë zë të veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

▪ **Për projektbuxhetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për pjesën e gjendjes civile, çështjet vendore dhe prefekturat.**

Në mbledhjen e Komisionit, për të paraqitur projektbuxhetin e viti 2019, mori pjesë zv.Ministri i Punëve të Brendshme, z.Julian Hodaj. Në projektligjin e buxhetit të vitit 2019 Ministria e Brendshme ka në përbërje të saj pesë programe buxhetore, të cilat janë ndarë në:

planifikim – menaxhim – administrim, Policia e Shtetit, Garda e Republikës, prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor si dhe Gjendja Civile.

Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në Komisionin për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Ministria e Brendshme nuk paraqiti kërkesa për fonde shtesë.

▪ **Për projektbuxhetin e Presidencës**

Sipas projektbuxhetit për vitin 2019, për këtë institucion është parashikuar në total buxheti prej 248 milionë lekësh, me një rritje krahasuar me buxhetin e vitit 2018.

Në seancën e zhvilluar në Komision, nga sekretari i Përgjithshëm i Presidencës u sqarua se parashikimet buxhetore në projektbuxhetin e vitit 2019, akomodojnë kërkesat e institucionit të Presidenti dhe nuk paraqiti kërkesa për fonde shtesë.

▪ **Për projektbuxhetin e Prokurorisë së Përgjithshme**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dëgjoi kërkesat e paraqitura nga përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme për buxhetin e vitit 2019.

Nga përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme u kërkua Shtesë me **197 punonjës** nga të cilët:

- 30 oficerë të policisë gjyqësore;
- 100 sekretare;
- 5 punonjës për dekriminalizimin;
- 30 ekspertë;
- 30 nëpunës të ndryshëm;
- 2 punonjës inxhinjerë.

Lidhur me kërkesat për buxhetin e vitit 2019, Komisioni vlerësoi se për shkak se ky institucion është në proces ndryshimesh si pasojë e reformës në drejtësi dhe në projektbuxhetin e vitit 2019 për institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme janë miratuar 50 punonjës shtesë, Komisioni miratoi edhe një shtesë prej 15 punonjësish duke e cuar në 65 numrin e punonjësve shtesë për këtë institucion nga të cilët:

- 30 Oficerë të Policisë Gjyqësore;
- 30 Koordinatorë;
- 5 punonjës për dekriminalizimin.

▪ **Për projektbuxhetin e pushtetit gjyqësor**

Buxheti i propozuar për vitin 2019 për zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, është afërsisht 2,4 miliardë lekë.

Përfaqësuesit e ZABGJ-së gjatë prezantimit të projektbuxhetit të vitit 2019 kërkuan që Komisioni të marrë parasysh kërkesën për:

1. 83 punonjës shtesë;
2. 10 punonjës të administratës gjyqësore, pa buxhet shtesë;

Nw përfundim, Komisioni miratoi dhe vendosi t'i propozojë Komisionit të Ekonomisë 10 punonjës shtesë për administratën gjyqësore në kuadër të sistemit të ri gjyqësor pa kosto shtesë. Miratimi i këtyre punonjësve shtesë është i lidhur me përmirësimin e cilësisë së shërbimit gjyqësor.

▪ **Për projektbuxhetin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

Këshilli i Lartë të Drejtësisë, në shkresën zyrtare drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe në seancën dëgjimore është shprehur se fondet buxhetore për këtë institucion plotësojnë kërkesat për një funksionim normal të punës në arritjen e objektivave për vitin 2019, duke argumentuar një tejkalim në shumën 28.000 në mijë lekë në zërin paga dhe sigurime shoqërore si rezultat i ndryshimit të nivelit të pagave për Inspektorët e Inspektoratit të KLD-së të cilët gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit.

Lidhur me këtë kërkesë komisioni vendosi që pas rakordimit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të plotësohet fondi i pagave për përballimin e ndryshimit të nivelit të pagave për inspektorët e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

▪ **Për projektbuxhetin e Gjykatës Kushtetuese**

Në mbledhjen e Komisionit mori pjesë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese, i cili për projektbuxhetin e vitit 2019 për këtë institucion kërkoi që të merren parasysh kërkesat për:

- **10 punonjës shtesë** +fond pagash;
- **10 milionë lekë** shtesë në zërin investime për rikonstruksionin e godinës;
- shtesë në zërin investime, për përfundimin e projektit të informatizimit dhe dixhitalizimit të vendimmarrjes së gjykatës, për fondin e bibliotekës, për pajisje zyre dhe gjenerator, si dhe për blerje automjeti.

Në përfundim, për këtë institucion, Komisioni duke vlerësuar së numri aktual i punonjës, në total 62, mbështetur edhe në numrin shtesë prej 8 punonjës të miratuar në vitin 2017 është i mjaftueshëm për të garantuar funksionimin normal të këtij institucioni.

▪ **Për projektbuxhetin e Avokatit të Popullit:**

Në mbledhjen e Komisionit përfaqësuesit e Avokatit të Popullit paraqitën kërkesat e mëposhtme:

- 2 milionë lekë shtesë shpenzime operative për aktivitete;
- 2 punonjës shtesë (ndihmëskomisionerë);
- Rritje e pagës së AP dhe komisionerëve , sipas rritjes së pagave për gjyqtarët;

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës të miratojë një shtesë 2 milionë lekë në zërin shpenzime operative, për këtë institucion për zhvillimin e metodologjive të lidhura me ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, në kuadër të vijimit të projektit të filluar me mbështetjen e qeverisë daneze.

▪ **Për projektbuxhetin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive**

Në seancën e zhvilluar në Komisionin për Çështjet Ligjore, përfaqësuesja e ILDKPKI-së, prezantoi kërkesat e këtij institucioni për projektbuxhetin 2019.

Përfaqësuesja e ILDKPKI-së paraqiti kërkesën për fonde shtesë në zërin shpenzime në vlerën **4 milionë lekë**, për mirëmbajtjen e sistemit elektronik të deklarimit on-line.

Komisioni, vendosi të miratojë dhe t'i propozojë Komisionit të Ekonomisë shtesën në vlerën 4 milionë lekë në zërin e shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e sistemit online të deklarimit të interesave privatë.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Në mbledhjen e Komisionit mori pjesë Kryetari e KQZ-së, i cili paraqiti kërkesat e institucionit, si më poshtë:

Në zërin investime kërkohen **47.244 milionë lekë shtesë** nga të cilat:

a. fonde për rikonstrukcionin dhe përshtatje e magazinës së bazës materiale në Lundër afërsisht në **27 milionë lekë**.

b. blerja e dy automjeteve. Kosto e parashikuar është në vlerën **6.175 milionë lekë**.

c. Shtesë kati dhe ndërtim ambiente pune dhe hapësira të përbashkëta për administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Tiranë në vlerën **14.069 milionë lekë**.

Komisioni, miratoi kërkesën e KQZ për shtesë fondi në zërin investime në vlerën 27 milion lekë për rikonstrukcionin dhe përshtatje e magazinës së bazës materiale në Lundër në kuadër të marrjes së masave për përgatitjen e procesit të zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor të vitit 2019.

▪ **Për projektbuxhetin e Shkollës së Magjistraturës**

Në mbledhjen e Komisionit morën pjesë përfaqësues nga Shkolla e Magjistraturës të cilët paraqitën kërkesat e tyre lidhur me projektbuxhetin e vitit 2019. Konkretisht për këtë institucion u paraqitën këto kërkesa:

1. Shtesë **3 punonjës** (fondi i pagave 5 531 000 lekë)
2. Në zërin shpenzime kapitale shtesë për blerje autoveturë (**5 milion lekë**)

Në përfundim Komisioni vendosi të miratojë dhe t'i propozojë Komisionit përgjegjës për ekonominë dhe financat për këtë institucion, shtesë në zërin e shpenzimeve kapitale në masën 5 milion lekëve për blerjen e një furgoni për nevoja të institucionit.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**

Në mbledhjen e Komisionit mori pjesë Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili paraqiti kërkesat për:

- 4 punonjës (inspektorë) shtesë;
- 5 milion lekë për shpenzime për monitorimin e vitit zgjedhor;
- 3 milion lekë për blerje automjeti;
- rritje të kategorisë së pagave për dy pozicione pune;

Komisioni për Cështjet miratoi kërkesën për:

- **4 milion lekë shtesë për shpenzime për vitin zgjedhor për kontrollin e administratës publike gjatë fushatës zgjedhore;**
- **2 milion lekë shtesë për shpenzime të tjera operative.**

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Komisioni u njoh me kërkesën e paraqitur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale z.Besnik Dervishi, i cili paraqiti kërkesë për:

1. Shtesë strukture për 9 punonjës, dhe fond pagash në masën 12.750 (në mijë lekë), të shpërndarë brenda 3 viteve. Për 2019 kërkohet buxhetimi për 3 punonjës shtesë.
2. Shtesën në shumën **25.000 (në mijë) lekë, në zërin 602** për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë.
3. Për zërin investime në vlerën **28.000 (në mijë lekë)** të detajuar si më poshtë:
 - a. Krijimi, administrimi dhe monitorimi i Regjistrat elektronik të thirrjeve të padëshiruara, në shumën 10.000 (në mijë lekë).
 - b. Rikonstruksion godine (për sallën multifunksionale), i cili parashikohet të jetë në shumën 10.000 (në mijë lekë).
 - c. Blerje të pajisjeve kompjuterike/elektronike”, në shumën 2 000 (në mijë lekë).
 - d. “Blerje pajisje” (për sallën multifunksionale), në shumën 3 000 (në mijë lekë).
 - e. “Blerje pajisje të tjera/instrumenta e vegla”, (për sallën multifunksionale), në shumën 3 000 (në mijë lekë)

Në përfundim Komisioni vendosi të miratojë dhe t'i propozojë Komisionit të Ekonomisë për këtë institucion, kërkesën për:

- a. akordimin e fondeve në zërin paga dhe sigurime shoqërore për 3 punonjës shtesë.
- b. shtesë fondi prej 15 milion lekë në zërin investime për rikonstruksion salle dhe blerje pajisjesh.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

Komisioni u njoh me prezantimin e projektbuxhetit nga përfaqësues të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të cilët paraqitën kërkesën për:

Shtesën për fond pagash dhe sigurimesh shoqërore në vlerën e **57.022 (në mijë lekë)**, për reflektimin e vendimit të Kuvendit 88/2018 sipas të cilit numri i punonjësve të institucioni është shtuar me 9 punonjës.

Komisioni i miratoi kërkesën e institucioni për të reflektuar në buxhetin e 2019 në zërin përkatës (paga dhe sigurime shoqërore) dhe në shtojcën përkatëse të numrit të punonjësve në njësitë shpenzuese, shtesën prej 9 punonjësish të miratuar me vendimin e Kuvendit nr.88/2018.

▪ **Për projektbuxhetin e Autoritetit Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit**

Kryetarja e Autoritetit gjatë seancës dëgjimore në Komision paraqiti kërkesat si vijon:

- a. Kërkesë për shtesë punonjësish, sipas strukturës së miratuar nga Kuvendi. Aktualisht institucioni ka 30 punonjës, ndërkohë që në strukturë e miratuar nga Kuvendi me vendimin nr. 95/2016 janë parashikuar 60 punonjës.
- b. Shtesë në zërin shpenzime operative **5 milion lekë** (sensibilizim për veprimtarinë e Autoritetit, trajnime)
- c. Kërkesë në zërin investime nga të cilat:
 - i. Për financimin e projektit për rikonstrukcionin e godinës **121,5 milion lekë**.
 - ii. Loti më emergjent kthimi në gjendje pune i zyrave të arkivës **23.3 milion lekë**;
 - iii. Mbikëqyrje punimesh mbi vlerën e projektit **2.2 milion lekë**;

Skenari minimalist i kërkuar nga Autoriteti gjatë seancës dëgjimore:

- fond shtesë për paga dhe sigurime shoqërore në vlerën **13 400 000 lekë** për një shtesë prej 10 punonjësish.
- Përfundimi i rikonstrukcionit dhe kthimi në gjendje pune i zyrave të arkivës në shumën 23 milion lekë.

Komisioni për Çështjet Ligjore miratoi kërkesën e këtij institucioni:

- a. akordimin e fondit të nevojshëm në zërin paga dhe sigurime shoqërore për 10 punonjës të cilët janë miratuar me vendim të Kuvendit nr. 95/2016. Shtesa prej 10 punonjësish duhet të reflektohet edhe në shtojcën përkatëse ku parashikohet numri i punonjësve të njërive shpenzuese.

- b. shtesë fondi për investime në vlerën 23 milion lekë për rikonstrukcionin dhe kthimin në gjendje pune të zyrave të arkivës.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

Përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë seancës dëgjimore në komision parashitroi:

1. Fondet e akorduara në zërin paga dhe sig shoqërore për vitin 2019 nuk kanë parashikuar fondet e nevojshme për shtesën e numrit të punonjësve të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 100/2018 prej 14 punonjësish.
2. Të parashikohen fondet për sigurimin e jetës dhe shëndetit të Komisionerëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Komisioni, pasi vlerësoi kërkesat e këtij institucioni miratoi kërkesën e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të reflektuar në buxhetin e këtij institucioni, në zërin e pagave dhe sigurimeve shoqërore, fondin për përballimin e shtesës prej 14 punonjësish të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 100/2018, pas rakordimit me ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

▪ **Për projektbuxhetin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

Përfaqësuesit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjatë seancës dëgjimore në komision paraqitën kërkesat për:

1. Fondet e akorduara në zërin paga dhe sig shoqërore për vitin 2019 nuk reflektojnë shtesën në strukturën e miratuar për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit me vendimin e Kuvendit nr. 101/2018 prej 6 punonjësish shtesë. **Kërkohet shtesë për shpenzime personeli në shumën 19.3 milion lekë.**
2. Shtesë në zërin investime në shumën **12.7 milion lekë** për blerje skaner për kontroll dhe dedektor.

Komisioni, për Çështjet Ligjore miratoi kërkesën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për:

- a. të reflektuar në buxhetin e këtij institucioni në zërin e pagave dhe sigurimeve shoqërore fondin për përballimin e shtesës prej 6 punonjësish të miratuar me vendimin e Kuvendit nr.101/2018 pas rakordimit me ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
- b. shtesë fondi në zërin e investimeve në masën e 12.7 milion lekë për blerje skaner për kontroll dhe dedektor.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionerëve Publikë**

Komisionerët Publikë gjatë seancës dëgjimore në komision u shpreh se:

- Fondet e akorduara në zërin paga dhe sig shoqërore për vitin 2019 nuk reflektojnë shtesën në strukturën e miratuar për IKP me vendimin e Kuvendit nr. 102/2018 prej 4 punonjësish. **Kërkohet shtesë në vlerën 14.000 mijë lekë në zërin e pagave dhe 400 mijë lekë në zërin e sigurimeve shoqërore.**

Komisioni miratoi kërkesën e Institucionit të Komisionerëve Publikë për të reflektuar në buxhetin e institucionit në zërin e pagave dhe sigurimeve shoqërore fondin për përballimin e shtesës prej 4 punonjësish të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 102/2018 pas rakordimit me ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

▪ **Për projektbuxhetin e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit**

Transferimi i fondit prej 2 milion lekë i parashikuar në zërin investime, në zërin shpenzime kapitale shtesë për blerje autoveturë.

Komisioni vlerëson që kjo kërkesë të adresohet pas miratimit të buxhetit bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

Të gjitha ndryshimet e miratuara më sipër nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të reflektohen në tabelën 1 të projektligjit “Buxheti 2019 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve të buxhetore”, si dhe në tabelën 2 që parashikon numrin e punonjësve për vitin 2019.

- **REKOMANDIME PËR KOMISIONIN PËRGJEGJËS**

Gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozim të relatorit komisioni vlerësoi t'i adresojë komisionit përgjegjës për ekonominë dhe financat:

1. Të shikojë mundësinë e parashikimit të një fondi të posaçëm për sigurimin e jetës dhe shëndetit të anëtarëve të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo kërkesë mbështet në përcaktimet e bëra nga neni 25 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas të cilit: *“Anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, personat e lidhur me ta, personeli i institucioneve të rivlerësimit, si dhe personeli mbështetës i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit gëzojnë të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti për jetën, shëndetin dhe pasurinë e tyre, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e veçantë.”*
2. Të shikojë mundësinë që pa cënuar shumat e parashikuara në transfertën e pakushtëzuar për vitin 2019 për 61 bashkitë, të parashikohet një kolonë e veçantë e destinuar për bashkitë që mbulojnë territore të zonës bregdetare, përcaktimi i një shtesë mbi atë të përfutur si rezultat i ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, për shkak të rritjes së konsiderueshme të numrit të turistëve vendas dhe të huaj. Ndërkohë që për bashkitë, që kanë në juridiksionin e tyre zona/objekte të mbrojtura nga UNESCO të merret në konsideratë reflektimi i

argumenteve të dhëna në relacionin shoqërues të projekt-buxhetit 2019, duke parashikuar një fond shtesë mbi atë të përcaktuar për këto bashki si rezultat i ndarjes së transfertës së pakushtëzuar.

- PËRFUNDIM

Në përfundim të të gjitha shqyrtimeve, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, duke vlerësuar domosdoshmërinë për garantimin e mirëfunksionimit të organeve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, bazuar në nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, u shpreh dakord për miratimin e projektligjit “Për Buxhetin e Shtetit të Vitit 2019”, nen për nen, dhe në tërësi.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në përputhje me afatet e përcaktuara në kalendarin e Kuvendit sipas nenit 79 të Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e projektbuxhetit të Shtetit të Vitit 2019, e paraqet këtë raport në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, si dhe në seancën plenare.

(Bashkëlidhur tabela përmbledhëse me kërkesat e miratuara nga Komisioni)

RELATOR

KRYETAR

Bashkim FINO

Ulsi MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

T A B E L A
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2019”

Nr	INSTITUCIONET	KËRKESAT E INSTITUCIONEVE	TË MIRATUARA NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE
1	Ministria e Drejtësisë	-në zërin shpenzime operative kërkon shtesë 643 milion lekë për policinë e burgjeve, për unifikimin e gradave; - në zërin shpenzime kapitale 100 milion lekë për institutin e të miturve;	Në përfundim, Komisioni, pas rakordimit dhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, vlerësoi se kërkesa për shtesë fondi për unifikimin e gradave në Policinë e Burgjeve është akomoduar në projekt-buxhetin e vitit 2019, në të cilin është parashikuar rritje të pagave për Policinë e Burgjeve.
2.	PRESIDENCA	Nuk paraqiti kërkesa.	
3.	Prokuroria e Përgjithshme	1. Shtesë 197 punonjës nga të cilët: -30 oficerë të policisë gjyqësore; -100 sekretare; -5 punonjës për dekriminalizimin; 30 ekspertë; -30 nëpunës të ndryshëm; -2 punonjës inxhinjerë.	Lidhur me kërkesat për buxhetin e vitit 2019, Komisioni vlerësoi se për shkak se ky institucion është në proces ndryshimesh si pasojë e reformës në drejtësi dhe në projekt-buxhetin e vitit 2019 për institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme janë miratuar 50 punonjës shtesë, Komisioni miratoi edhe një shtesë prej 15 punonjësish duke e cuar në 65 numrin e punonjësve shtesë për këtë institucion nga të cilët: - 30 Oficerë të Policisë Gjyqësore; - 30 Koordinatorë; - 5 punonjës për dekriminalizimin.
4.	Zyra e Administrimit të Buxhetit të Pushtetit Gjyqësor	1. 83 punonjës shtesë ; 2. 10 punonjës të administratës gjyqësore, pa buxhet shtesë;	Komisioni miratoi dhe vendosi t'i propozojë Komisionit të Ekonomisë 10 punonjës shtesë për administratën gjyqësore në kuadër të sistemit të ri gjyqësor pa kosto shtesë. Miratimi i këtyre punonjësve shtesë është i lidhur me përmirësimin e cilësisë së shërbimit gjyqësor.

5.	Avokati i Popullit	<p>-2 milionë lekë shtesë shpenzime operative për aktivitete;</p> <p>-2 punonjës shtesë (ndihmëskomisionerë);</p> <p>-Rritje e pagës së AP dhe komisionerëve , sipas rritjes së pagave për gjyqtarët;</p>	<p>Komisioni vendosi të miratojë kërkesën për 2 milionë lekë shtesë shpenzime operative për zhvillimin e metodologjive të lidhura me ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në kuadër të vijimit të projektit të filluar me mbështetjen e qeverisë daneze.</p>
6.	Gjykata Kushtetuese	<p>-10 punonjës shtesë +fond pagash;</p> <p>- 10 milionë lekë shtesë në zërin investime për rikonstruksionin e godinës;</p> <p>-shtesë në zërin investime, për përfundimin e projektit të informatizimit dhe dixhitalizimit të vendimmarrjes së gjykatës, për fondin e bibliotekës. për pajisje zyre dhe gjenerator, si dhe për blerje automjeti.</p>	<p>Komisioni duke vlerësuar së numri aktual i punonjës, në total 62, mbështetur edhe në numrin shtesë prej 8 punonjës të miratuar në vitin 2017 është i mjaftueshëm për të garantuar funksionimin normal të këtij institucioni.</p>
7.	ILDKPKI	<p>Shtesë në zërin shpenzime në vlerën 4 milionë lekë, për mirëmbajtjen e sistemit elektronik të deklarimit <i>on-line</i>.</p>	<p>Komisioni miratoi kërkesën për shtesë në vlerën 4 milionë lekë në zërin e shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e sistemit online të deklarimit të interesave privatë.</p>
8.	Ministria e Brendshme (gjendja civile, prefekturat)	<p>Nuk paraqiti kërkesa shtesë</p>	
9.	Autoriteti Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit	<p>-Kërkesë për shtesë punonjësish, sipas strukturës së miratuar nga Kuvendi. Aktualisht ka 30 punonjës, ndërkohë që në strukturë e miratuar nga Kuvendi me vendimin nr. 95/2016 janë parashikuar 60.</p> <p>-Shtesë në zërin shpenzime operative 5 milion lekë (sensibilizim për veprimtarinë e Autoritetit, trajnime)</p> <p>-Kërkesë në zërin investime nga të cilat:</p>	<p>Komisioni miratoi kërkesën për:</p> <p>a. akordimin e fondit të nevojshëm në zërin paga dhe sigurime shoqërore për 10 punonjës të cilët janë miratuar me vendim të Kuvendit nr. 95/2016.</p> <p>b. shtesë fondi për investime në vlerën 23 milion lekë për rikonstruksionin dhe kthimin në gjendje pune të zyrave të arkivës.</p>

		<p>1. Për financimin e projektit për rikonstruksionin e godinës 121,5 milion lekë.</p> <p>2. Loti më emergjent kthimi në gjendje pune i zyrave të arkivës 23.3 milion lekë;</p> <p>3. Mbikëqyrje punimesh mbi vlerën e projektit 2.2 milion lekë;</p> <p>Skenari minimalist i kërkuar nga Autoriteti gjatë seancës dëgjimore: a- fond shtesë për paga dhe sigurime shoqërore në vlerën 13 400 000 lekë për një shtesë prej 10 punonjësish. b- Përfundimi i rikonstruksionit dhe kthimi në gjendje pune i zyrave të arkivës 23 milion lekë.</p>	
10	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	<p>Në zërin investime kërkohen 47.244 milionë lekë shtesë nga të cilat:</p> <p>a. fonde për rikonstruksionin dhe përshtatje e magazinës së bazës materiale në Lundër afërsisht në 27 milionë lekë.</p> <p>b. blerja e dy automjeteve. Kosto e parashikuar është në vlerën 6.175 milionë lekë.</p> <p>c. Shtesë kati dhe ndërtim ambiente pune dhe hapësira të përbashkëta për administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Tiranë në vlerën 14.069 milionë lekë.</p>	<p>Komisioni miratoi kërkesën e KQZ për shtesë fondi në zërin investime në vlerën 27 milion lekë për rikonstruksionin dhe përshtatje e magazinës së bazës materiale në Lundër.</p>
11	Shkolla e Magjistraturës	<p>1. Shtesë 3 punonjës (fondi i pagave 5 531 000 lekë)</p> <p>2. Në zërin shpenzime kapitale shtesë për blerje autoveturë (5 milion lekë)</p>	<p>Komisioni miratoi kërkesën për shtesë në zërin e shpenzimeve kapitale të në masën 5 milion lekëve për blerjen e një furgoni për nevoja të institucionit.</p>
12	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	<p>Kërkesë për:</p> <p>1. Shtesë strukture për 9 punonjës, dhe fond pagash në masën 12.750 (në mijë lekë), të shpërndarë</p>	<p>Komisioni miratoi kërkesën për:</p> <p>a. akordimin e fondeve në zërin paga dhe sigurime shoqërore për 3 punonjës shtesë.</p>

		<p>brenda 3 viteve. Për 2019 kërkohet buxheti për 3 punonjës shtesë.</p> <p>2. Shtesën në shumën 25.000 (në mijë) lekë, në zërin 602 për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë.</p> <p>3. Për zërin investime në vlerën 28.000 (në mijë lekë) të detajuar si më poshtë:</p> <p>a. Krijimi, administrimi dhe monitorimi i Regjistrimit elektronik të thirrjeve të padëshiruara, në shumën 10.000 (në mijë lekë).</p> <p>b. Rikonstruksion godine (për sallën multifunkionale), i cili parashikohet të jetë në shumën 10.000 (në mijë lekë).</p> <p>c. Blerje të pajisjeve kompjuterike/elektronike”, në shumën 2 000 (në mijë lekë).</p> <p>d. “Blerje pajisje” (për sallën multifunkionale), në shumën 3 000 (në mijë lekë).</p> <p>e. “Blerje pajisje të tjera/instrumenta e vegla”, (për sallën multifunkionale), në shumën 3 000 (në mijë lekë)</p>	<p>b. shtesë fondi prej 15 milion lekë në zërin investime për rikonstruksion salle dhe blerje pajisjesh.</p>
13	Komisioni për Shërbimin Civil	<p>Kërkesë për:</p> <p>-4 punonjës (inspektorë) shtesë; -5 milion lekë për shpenzime për monitorimin e vitit zgjedhor; -3 milion lekë për blerje automjeti; -rritje të kategorisë së pagave për dy pozicione pune;</p>	<p>Komisioni miratoi kërkesën për:</p> <p>-4 milion lekë shtesë për shpenzime për vitin zgjedhor për kontrollin e administratës publike gjatë fushatës zgjedhore; -2 milion lekë shtesë për shpenzime të tjera operative.</p>
14	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	<p>Kërkesë për:</p> <p>Shtesën për fond pagash dhe sigurimesh shoqërore në vlerën e 57.022 (në mijë lekë), për reflektimin e vendimit të Kuvendit 88/2018 sipas të cilit numri i punonjësve të KMD është shtuar me 9 punonjës.</p>	<p>Komisioni i miratoi kërkesën e institucioni për të reflektuar në buxhetin e 2019 në zërin përkatës (paga dhe sigurime shoqërore) shtesën <u>prej 9 punonjësish të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 88/2018.</u></p>

15	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	Transferimi i fondit prej 2 milion lekë i parashikuar në zërin investime, në zërin shpenzime kapitale shtesë për blerje autoveturë.	
16	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	Tejkalim në shumën 28.000 në mijë lekë në zërin paga dhe sigurime shoqërore si rezultat i i ndryshimit të nivelit të pagave për Inspektorët e Inspektoratit të KLD-së të cilët gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit.	Komisioni vendosi që pas rakordimit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të plotësohet fondi i pagave për përballimin e ndryshimit të nivelit të pagave për inspektorët e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
17	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	1. Fondet e akorduara në zërin paga dhe sig shoqërore për vitin 2019 nuk kanë parashikuar fondet e nevojshme për shtesën e numrit të punonjësve të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 100/2018 prej 14 punonjësish. 2. Të parashikohen fondet për sigurimin e jetës dhe shëndetit të Komisionerëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.	Komisioni, pasi vlerësoi kërkesat e këtij institucioni miratoi kërkesën e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të reflektuar në buxhetin e këtij institucioni, në zërin e pagave dhe sigurimeve shoqërore fondin për përballimin e shtesës prej <u>14 punonjësish të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 100/2018, pas rakordimit me ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.</u>
18	Kolegji i Posaçëm i Apelit	1. Fondet e akorduara në zërin paga dhe sig shoqërore për vitin 2019 nuk reflektojnë shtesën në strukturën e miratuar për Kolegjin e Posaçëm të Apelit me vendimin e Kuvendit nr. 101/2018 prej 6 punonjësish shtesë. Kërkohet shtesë për shpenzime personeli në shumën 19.3 milion lekë. 2. Shtesë në zërin investime në shumën 12.7 milion lekë për blerje skaner për kontroll dhe dedektor.	Komisioni, për Çështjet Ligjore miratoi kërkesën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit për: a. të reflektuar në buxhetin e këtij institucioni në zërin e pagave dhe sigurimeve shoqërore fondin për përballimin e shtesës <u>prej 6 punonjësish të miratuar me vendimin e Kuvendit nr.101/2018 pas rakordimit me ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.</u> b. shtesë fondi në zërin e investimeve në masën e <u>12.7 milion lekë</u> për blerje skaner për kontroll dhe dedektor.
19	Komisionerët Publikë	Fondet e akorduara në zërin paga dhe sig shoqërore për vitin 2019 nuk reflektojnë shtesën në strukturën e miratuar për IKP me vendimin e Kuvendit nr. 102/2018 prej 4 punonjësish. Kërkohet shtesë në vlerën 14.000 mijë lekë në zërin e pagave dhe 400 mijë lekë në zërin e sigurimeve shoqërore.	Komisioni miratoi kërkesën e Institucionit të Komisionerëve Publikë për të reflektuar në buxhetin e institucionit në zërin e pagave dhe sigurimeve shoqërore fondin për përballimin e shtesës prej 4 punonjësish të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 102/2018 pas rakordimit me ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

